

Vendim nr. 259, datë 20.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 20.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: DASHMIRA ZARO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2026-969, datë 27.03.2026 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për akses në gjykatë dhe i mungesës së një mjeti efektiv në dispozicion të kreditorit për përshpejtimin e gjykimit të çështjes nr. 31138-01792-86-2025 nga Gjykata Administrative e Apelit.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes 31138-01792-86-2025 nga Gjykata Administrative e Apelit. Urdhërimi i gjykimit të menjëhershëm të çështjes.

Konstatimi i cenimit të së drejtës së pronësisë, për shkak të kohëzgjatjes mbi 11 vjet të kufizimeve të vendosura mbi pronën me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 15.04.2015 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, rikonstrukcion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit”.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Në datën 15.04.2015, me vendimin nr. 322 (*VKM nr. 322/2015*), Këshilli i Ministrave ka vendosur shpronësimin për interes publik të disa pasurive të prekura nga projektet në Parkun e Viroit, ndër të cilat edhe pasuria e kërkueses.

2. Duke pretenduar se VKM-ja në fjalë prekte tagrat e saj të pronësisë, kërkuësja i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi për ndalimin e cenimit të së drejtës së pronës dhe urdhërimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Gjirokastrë (*ZVRPP*) që brenda 30 ditëve të hidhte gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas VKM-së.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka pranuar pjesërisht padinë, duke urdhëruar ZVRPP-në të hedhë gjurmën e projektit dhe të pajisë kërkuësen me certifikatë pronësie për pjesën e mbetur nga shpronësimi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe më pas nga Gjykata e Lartë.

4. Me marrjen formë të prerë të vendimit, përmes Zyrës Përmbarimore Gjirokastrë, kërkuësja ka vënë në lëvizje procedurat e ekzekutimit. Për këtë qëllim, ajo i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Dega Vendore Gjirokastrë (*ASHK-ja, Gjirokastrë*), së cilës me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për kadastrën” i kanë kaluar kompetencat e ish-ZVRPP-së, Gjirokastrë, me kërkesë për ekzekutimin vullnetar të vendimit.

5. Pavarësisht depozitimit të dokumentacionit të kërkuar dhe tërheqjes së vëmendjes nga zyra e përmbarimit, ASHK-ja, Gjirokastrë nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e vendimit. Në këtë situatë, Zyra e Përmbarimit Gjirokastrë i është drejtuar gjykatës

administrative me kërkesë për gjobitjen e ASHK-së, Gjirokastrë, për shkak të moszekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

6. Me vendimin nr. 170, datë 17.12.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë ka rrëzuar kërkesën, me arsyetimin se Zyra e Përmbartimit Gjirokastrë nuk kishte provuar nëse kishte kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të vendimit, sa ishte afati që i kishte caktuar debitorit për ekzekutimin e këtij detyrimi, si dhe nëse kishte kryer veprime të tjera procedurale, sipas parashikimeve të KPC-së.

7. Kundër këtij vendimi Zyra Përmbartimore Gjirokastrë ka paraqitur ankim, i cili është lejuar me vendimin e datës 10.02.2025 të gjyqtarës së vetme të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe, në vijim, çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 13.06.2025 me nr. 31138-01792-86-2025.

8. Po kështu, me pretendimin se kishte nxjerrë vendimin për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, zyra e përmbartimit i është drejtuar sërish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë me kërkesë për gjobitjen e debitorit. Duke vënë në dukje se kjo kërkesë përbënte përsëritje të kërkesës së parë dhe se zyra përmbartimore nuk kishte ezauruar veprimet e parashikuara nga KPC-ja, në interpretim të nenit 58 të këtij kodi, me vendimin nr. 98, datë 05.05.2025, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit.

9. Në vijim, në kushtet e mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit (*shih paragrafin 7 të vendimit*), kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke parashtruar se nga data e vënies në lëvizje të procesit gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nga zyra e përmbartimit kishin kaluar mbi 18 muaj pa pasur një vendimmarrje të formës së prerë, ndërsa nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit kishin kaluar më shumë se 7 muaj. Kërkuësja ka pretenduar gjithashtu se nuk ishte thirrur si palë në gjykim nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk i ishin komunikuar aktet e depozituara nga zyra e përmbartimit, deklaratimet e debitorit e ankimi i zyrës së përmbartimit.

10. Në interpretim të neneve 399/1 – 399/11 të KPC-së, me vendimin nr. 00-2026-969, datë 27.03.2026, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se kërkuësja nuk legjitimohej në paraqitjen e saj, pasi, edhe pse kishte vënë në lëvizje procedurën përmbartimore, ajo nuk kishte qenë palë në procesin për të cilin kërkohej konstatimi i shkeljes e përsheptimi i gjykimit. Sipas Kolegjit Administrativ, thjesht fakti që një individ mund të kishte interesa në një proces gjyqësor nuk e legjitimonte atë për paraqitjen e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit. Individët mund të

paraqisnin të tilla kërkesa vetëm nëse ishin palë në proces. Në këtë fazë kërkuases nuk i cenohej ndonjë interes, pasi ligjvënësi kishte përcaktuar se procesi i ekzekutimit iniciohej nga përmbaruesi dhe kishte të bënte me veprime ngushtësisht procedurale në funksion të tij. Për më tepër, gjykimi në fjalë nuk pengonte vijimin e procedurave përmbarimore ose të kërkesave të tjera të përmbaruesit për sanksionimin e palës që pengonte ekzekutimin ose kryerjen e veprimeve të kërkuara.

II

Pretendimet e kërkuases

11. Kërkesja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1. *Së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, në kundërshtim nga sa Gjykata e Lartë ka arsyetuar: i) çdo vonesë në fazën e ekzekutimit cenon interesat e kreditorit, i cili ka interes për gjykimin sa më të shpejtë të gjykimit të iniciuar nga zyra e përmbarimit, në ndryshim nga kjo e fundit, e cila nuk ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit. Interesi i kreditorit nuk mund të konsiderohet i shuar vetëm për shkak se kërkesa paraqitet formalisht nga zyra e përmbarimit. ii) Fakti që kërkesja nuk ka qenë palë në proces është rrjedhojë e mangësive procedurale të gjykatës, e cila nuk e ka thirrur në gjykim, ndaj pasojat e kësaj shtate nuk mund t'i ngarkohen asaj.

11.1.2. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ankimi është depozituar nga zyra e përmbarimit në datën 29.01.2025, ndërsa çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 13.06.2025. Vonesa në përcjelljen e tij dhe në gjykimin e çështjes është rrjedhojë e veprimeve të organeve gjyqësore. Ndonëse për nga natyra çështja është e tillë që kërkon prioritet në shqyrtim, ajo është ende në pritje ndonëse kanë kaluar mbi 11 muaj nga data e regjistrimit të saj në gjykatën e apelit. Po kështu, çështja nuk është komplekse dhe tejzgjatja e ekzekutimit është rrjedhojë e veprimeve të ASHK-së, Gjirokastër.

11.2. *E drejta për mjete juridike efektive*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim formalist në cenim të kësaj të drejte.

12. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në drejtim të gëzimit e disponimit të qetë të saj, pasi prej 11 vjetësh prona vazhdon të jetë e kufizuar, si rrjedhojë e zbatimit të VKM-së nr. 322/2015, ndërsa ASHK-ja, Gjirokastrë nuk ka hedhur ende gjurmën e projektit, sipas vendimit gjyqësor. Kjo ka sjellë si pasojë edhe zhvleftësimin e pronës, duke u vendosur ndaj kërkueses një barrë disproporcionale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Lidhur me legjitimitetin *ratione personae* në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 36, datë 19.03.2026; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor Gjykata ka pranuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nenit 6 i KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142, pika 3, të Kushtetutës, nënvizon faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj (*shih vendimet nr. 29, datë 30.04.2025; nr. 50, datë 03.07.2017; nr. 21, datë 07.04.2014 të Gjykatës*

Kushtetuese). Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 79, datë 27.12.2016; nr. 14, datë 30.03.2015; nr. 21, datë 07.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor administrativ është rregulluar nga nenet 65 – 69 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), ku neni 65, pika 1, parashikon se vendimi përfundimtar i gjykatës administrative, që ka marrë formë të prerë, vihet në ekzekutim nga përmbauesi gjyqësor me kërkesën e kreditorit. Edhe sipas dispozitave të KPC-së, që, sipas parashikimeve të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, gjejnë zbatim edhe në çështjet administrative, urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbaues gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbauesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit (*neni 515 i KPC-së*). Nga ana tjetër, neni 610 i KPC-së garanton të drejtën e kreditorit për të kundërshtuar në gjykatën që ekzekuton vendimin refuzimin e përmbauesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji.

17. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se, pas njohjes nga gjykatat administrative së të drejtës së kërkueses dhe përcaktimit të detyrimit të ZVRPP-së për kryerjen e veprimeve konkrete (*shih paragrafin 3 të vendimit*), kërkuessa ka vënë në lëvizje shërbimin përmbaues gjyqësor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 49/2012 dhe KPC-së (*shih paragrafët 5-6 të vendimit*). Në kuadër të procedurës së ekzekutimit, në mënyrë të përsëritur Zyra e Përmbaimit Gjyrokastër i është drejtuar ASHK-së, Gjyrokastër, duke kërkuar marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimit. Për shkak të mosveprimit të kësaj të fundit, zyra përmbaimore i është drejtuar dy herë gjykatës administrative të shkallës së parë me kërkesë për gjëmbitjen për këtë shkak të ASHK-së, Gjyrokastër (*shih paragrafët 6 dhe 8 të vendimit*). Këto kërkesa janë rrëzuar nga gjykata me arsyetimin se organi përmbaues nuk kishte ndjekur procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit, të parashikuar në ligj dhe KPC e nuk kishte ezaauruar veprimet e parashikuara nga ky kod për të garantuar ekzekutimin e vendimit. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 13.06.2025 bazuar në ankimin e zyrës së përmbaimit.

18. Në vijim, me pretendimin se ankimi i Zyrës së Përmbaimit Gjyrokastër nuk ishte shqyrtuar brenda një afati të arsyeshëm, kërkuessa i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e kësaj shkeljeje, duke parashtruar, ndër të tjera, edhe se procesi gjyqësor për fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor ishte zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë në

mungesë të saj. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se kërkesja nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi nuk kishte qenë palë në proces dhe se asaj nuk i ishin cenuar interesa, për sa kohë që procesi në fjalë ishte iniciuar nga zyra e përmbartimit, e cila për më tepër nuk kishte pengesë për vijimin e procedurave përmbartimore (*shih paragrafin 10 të vendimit*).

19. Për sa më sipër, në rastin konkret Kolegji vëren se, në thelb, në ankimin kushtetues individual kërkesja ka kërkuar konstatimin e shkeljes nga Gjykata Administrative e Apelit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të procesit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Në aspektin procedural palë ndërgjyqëse në atë proces kanë qenë Zyra e Përmbartimit Gjirokastër, ASHK-ja, Gjirokastër dhe zyra vendore e Avokaturës së Shtetit, Gjirokastër. Ndërkohë, pa qenë palë në proces, kërkesja ka vënë në lëvizje fillimisht Gjykatën e Lartë e më pas këtë Gjykatë për konstatimin e shkeljes në fjalë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk legjitimohet *ratione personae* në aspektin procedural për vënien në lëvizje të Gjykatës përmes ankimit kushtetues individual konkret, për sa kohë që nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Për më tepër, ajo ka ende mjete në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.